


Shërbimi i  
Seancës Plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KUVENDI**  
**Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**Lënda:** Propozohet një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

**Drejtuar:** Z. Niko PELESHI  
Kryetar i Kuvendit


**Këtu**

*Z. Kryetar i Kuvendit,*

Në mbështetje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëngjitur do të gjeni projektligjin “***Për Përgjegjësinë Financiare të Punonjësve Publikë***”, të shoqëruar me relacionin e tij.

Në përputhje me Rregulloren, kërkoj nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji nga Kuvendi i Shqipërisë.

*Duke ju falenderuar,*

**DEPUTETI**  
  
**BUJAR LESKAJ**

## **PROJEKT-LIGJ**

### **PËR PËRGJEGJËSINË FINANCIARE TË PUNONJËSVE PUBLIKË**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , me propozimin e deputetit Bujar Leskaj

#### **KUVENDI**

#### **I**

#### **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

#### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME**

##### **Neni 1**

##### **Objekti**

Objekti i këtij ligji është përgjegjësia financiare e punonjësve publikë, për dëmet e shkaktuara subjekteve publikë, gjatë kohës së marrëdhënieve me subjektin.


##### **Neni 2**

##### **Qëllimi**

Ligji ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet që lindin midis subjekteve publikë dhe punonjësve publikë, dhe të vendosë procedura lidhur me dëmet e shkaktuara prej këtyre të fundit, në periudhën që ata janë ose kanë qenë të punësuar ose në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik.

##### **Neni 3**

##### **Fushëveprimi**



Efektet e këtij ligji shtrihen mbi përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë, si dhe çdo personi apo subjekti që kryen funksione shtetërore ose funksione të deleguara, gjatë kohës së punësimit ose të marrëdhënies punës me subjektin publik në; Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në ndërmarrjet shtetërore dhe në shoqëritë tregtare ku shteti zotëron mbi 50 përqind të aksioneve.

Nuk janë subjekt i këtij ligji gjyqtarët dhe prokurorët , për vendimmarrjet e tyre vetëm për atë kohë sa janë duke ushtruar detyrën si të tillë.

Ky ligj zbatohet pavarësisht nga përgjegjësia disiplinore, administrative apo penale.

#### **Neni 4**

##### **Shpërblimi i dëmit**

Çdo punonjës publik, i cili gjatë punës ose jashtë saj, me dashje ose nga pakujdesia, i shkakton një dëm pasuror interesave të subjektit publik, është i detyruar të shpërblejë dëmin e shkaktuar sipas përcaktimeve të këtij ligji.

#### **Neni 5**

##### **Përkufizime**

1. "Subjekt publik"; në kuptimin e këtij ligji janë; njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron mbi 50 përqind të aksioneve.
2. "Punonjës publik"; janë punëtorët dhe nëpunësit e punësuar ose ish të punësuar ose në çfarë do marrëdhënie me subjektin publik.
3. "Njësi e qeverisjes së përgjithshme" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
4. "Organe kolegjiale"; në kuptim të këtij ligji janë trupa të zgjedhura apo të emëruara në subjektin publik, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale, të tilla si ; Bordet, Këshillat Drejtuese, Këshillat e Organeve të Qeverisjes

Vendore, komisionet e ndryshme dhe të tjera të ngjashme që , sipas ligjit kanë të drejta vendimmarrje.

5. "Subjekt i deleguar"; është subjekti, që vepron në bazë të autorizimit të subjektit publik, në emër dhe për llogari të këtij të fundit.
6. "Përgjegjësia financiare"; nënkupton shkallën në të cilën punonjësit e një subjekti publik, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar me faj ndaj subjektit publik. Përgjegjësia financiare, është detyrimi për të kompensuar në mënyrën dhe format e përcaktuara në këtë ligj, dëmin pasuror të shkaktuar me faj ndaj subjektit publik. Përgjegjësia financiare është; e plotë, e kufizuar, e përbashkët (solidare), përgjegjësia për sjelljet profesionale apo vendimmarrjet e paligjshme, përgjegjësia specifike e zyrtarëve publikë, përgjegjësia e rënduar dhe përgjegjësia për dëmet e shkaktuara palëve të treta.
7. "Dëmi pasuror"; është pakësimi real i pasurisë ose shpenzimet për riparimin e tij, plus fitimi i munguar, si dhe të drejtat e humbura që burojnë nga ajo pjesë e pasurisë së dëmtuar; përdorimi jo eficient i pasurisë apo mungesa e të ardhurave që duhet të realizoheshin, si dhe çdo humbje tjetër që pëson subjekti publik; rrjedhë e veprimeve apo sjelljeve profesionale të paligjshme.
8. "Sjellje profesionale e paligjshme"; Janë, veprimi ose veprimet e kryera me faj, nga punonjësi në ushtrimin e detyrës, në kundërshtim me ligjet , aktet nënligjore, rregullat dhe standardet etiko profesionale të pranuar që rregullojnë pozicionin përkatës të punës.
9. "Vendimmarrje e paligjshme"; Janë aktet administrative të nxjerra në kundërshtim me ligjin, nga punonjësit publikë dhe organet kolegjiale, që kanë kompetencë për t'i nxjerrë në bazë të ligjit, të cilat për shkak të paligjshmërisë së tyre, janë shfuqizuar nga vetë organi që i ka nxjerrë, janë anuluar nga organi administrativ më i lartë ose nga gjykata kompetente me vendim të formës së prerë dhe që i kanë shkaktuar një dëm pasuror subjektit publik.
10. "Këq besim"; konsiderohet mungesa e ndershmërisë së punonjësit publik në raport me ligjin, në një proces vendimmarrje apo sjellje profesionale.

## KREU II

### LLOJET E PËRGJEGJËSISË FINANCIARE

#### Neni 6

### **Përgjegjësia e plotë**

Përgjegjësia e plotë e punonjësit publik, konsiston në detyrimin e tij për të kompensuar subjektin publik, në vlerën e plotë të dëmit pasuror të shkaktuar. Rastet e përgjegjësisë së plotë të punonjësit publikë përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në to:

1. Dëmin e shkaktuar me dashje ose dëmet e shkaktuara nga vendimmarrje ose sjellje profesionale në keq besim.
2. Dëmin e shkaktuar, rrjedhojë e përgjegjësisë penale.
3. Dëmin e shkaktuar nga punonjësi në gjendje të dehur ose nën efektin e lëndëve psikotrope.
4. Dëmi i shkaktuar nga parashkrimi i një të drejte pasurore të subjektit publik, për faj të punonjësit publik.
5. Efektet dhe dëmet e shkaktuara nga mos zbatimi i vendimeve gjyqësore, që përfshijnë pagesat pas hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor të formës prerë, si dhe kostot e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore etj.
6. Pagimi interesave, gjobave, penalteteve, të çfarëdo lloji kur nuk ka një arsye të përligjur.
7. Mungesat në inventar e aktiveve ose mungesat e çfarëdo vlere që i është besuar në administrim punonjësit publik.
8. Dëmi i shkaktuar për shkak të zbulimit të informacioneve që përbëjnë një sekret për punëdhënësin ( sekret shtetëror ose tregtar)
9. Dëmi i shkaktuar nga punonjësi publik ndaj subjektit publik, jashtë kryerjes së funksioneve të ligjshme ose jashtë kohës së punës.
10. Përfitimet e padrejta të pagave dhe të shpërblimeve, brenda tre viteve nga dita që ato janë përfutur.
11. Raste të tjera dëmsh reale, me karakter të drejtpërdrejtë që nuk përfshihen në kategoritë e përcaktuara në nenin 7

### **Neni 7**

#### **Përgjegjësia e kufizuar**

Përgjegjësia e kufizuar i referohet detyrimit të punonjësit publik për të shlyer dëmin pasuror të shkaktuar, në një shumë më të ulët se vlera e plotë e dëmit pasuror.

Një punonjës publik ka përgjegjësi të kufizuar, kur:

1. Rastet e dëmeve nuk përfshihen në përcaktimet e nenit 6 të këtij ligji ose në kategoritë e

tjera të dëmeve të përcaktuara në nenin 8-10.

2. Punonjësi ka bërë përpjekje për zvogëlimin e dëmit të shkaktuar dhe provon se ka qenë në pamundësi për të ndaluar gjithë pasojat.

3. Dëmi shkaktuar nuk lidhet vetëm me fajin e punonjësit por edhe me përgjegjësinë e vetë subjektit publik.

4. Punonjësi nuk i kishte njohuritë e duhura tekniko profesionale.

5. Dëmet e shkaktuar nga sjellja e paligjshme profesionale e punonjësit, kur nuk vlerësohen si përgjegjësi e plotë në rastet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

6. Kur 50 % e të ardhurave personale të punonjësit nuk e mundësojnë shlyerjen e dëmit për një periudhë prej dhjetë vjetësh. Në këtë rast përgjegjësia zbatohet deri në këtë nivel.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësia e përbashkët**

Kur dëmi pasuror është shkaktuar nga disa punonjës, secili punonjës është përgjegjës për pjesën e dëmit të shkaktuar nga ai vetë. Nëse është e pamundur të përcaktohet se cila pjesë e dëmit është shkaktuar nga secili punonjës, të gjithë punonjësit konsiderohen njëloj përgjegjës dhe do të kompensojnë dëmin në pjesë të barabarta. Përgjegjësia e përbashkët mund të jetë e plotë ose e kufizuar.

Për dëmet e shkaktuara nga vendimmarrjet kolegjiale, anëtarët e këtyre organeve kanë përgjegjësi sipas qëndrimit të tyre në votim. Ata që votojnë kundër, në një proces vendimmarrje i cili ka sjellë një dëm pasuror, përjashtohen nga përgjegjësia. Anëtarët e organeve kolegjiale që janë të pranishëm në mbledhje dhe nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Abstenimi konsiderohet si votë pro. Vota kundër nga anëtarët e organeve kolegjiale, duhet deklaruar dhe arsyetuar. Ajo dokumentohet në proces verbalin e mbledhjes.

## **Neni 9**

### **Përgjegjësia financiare specifike e zyrtarëve publikë**

Përveç parashikimeve në nenin 6-8, zyrtarët publikë në të gjitha nivelet, janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara subjektit publik, rrjedhojë e sjelljeve të paligjshme profesionale apo e vendimmarrjeve të tyre të gabuara, të cilat nuk janë kryer me dashje direkte. Përgjegjësia e zyrtarëve publikë sipas këtij neni është deri shtatë paga mujore bruto por nuk mund të jetë më e madhe se 25 përqind e shumës së dëmit të llogaritur.

Zyrtarët publikë janë gjithashtu përgjegjës deri në masën e një page mujore edhe për dëmet e shkaktuara nga punonjësit në vartësi të tyre

Përgjegjësia e zyrtarëve publikë si më sipër i referohet:

1. Vendimmarrjeve të gabuara, të anuluar nga gjykata kompetente, me vendim të formës së prerë, ose nga organi administrativ më i lartë, të cilat kanë sjellë një dëm pasuror subjektiv.
2. Përdorimit jo eficient të mjeteve financiare, e konfirmuar nga strukturat e auditimit.
3. Blerjes dhe krijimit të mallrave stoqe, mbi nevojat e një viti pune.
4. Moszbatimit të detyrimeve kontraktore ndaj të tretëve dhe për rrjedhojë subjekti ka paguar ose mund të paguajë penalitete.
5. Përdorimit jashtë destinacionit i mjeteve financiare.
6. Mos aplikimi i duhur i çmimeve dhe tarifave të ndryshme që ndikojnë negativisht në të ardhurat e subjektivit.
7. Aplikimi i gabuar i grupeve, kategorive, shtesave ose elementëve që formojnë pagat e punonjësve
8. Dhënia e shpërblimeve të padrejta punonjësve.
9. Marrjes në punë të personave mbi numrin e caktuar ose në kundërshtim me procedurat e rekrutimit të parashikuara në legjislacion ose në statutin e subjekteve publike.
10. Mos vënia në rrugë arkëtimi, në një kohë përtej 45 ditëve, e detyrimeve të të tretëve ndaj subjektivit publik, pa arsye të përligjura.
11. Mos aplikimit i penaliteteve, për mos ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga mos zbatimi i kontratave nga subjektet kontraktore për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.
12. Pagimi i shpenzimeve për pritje e përcjellje dhe dhurata, në kundërshtim me ligjin dhe mbi normat e përcaktuar nga ligji.
13. Dëmit të shkaktuar subjektivit si rrjedhojë e aplikimit të gjobave ndaj subjektivit publik, të vëna nga autoritetet publike, për mos zbatimin e rregullave apo ligjeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
14. Vënies në dispozicion të zyrtarëve apo përdorimi prej tyre i aktiveve, në kundërshtim me ligjin.
15. Blerjes së makinerive dhe e pajisjeve, të cilat nuk vihen në shfrytëzim brenda gjashtë muajve nga data e blerjes kur dëmi nuk vlerësohet si përgjegjësi e plotë në kushtet e nenit
16. Dëmtimit të aktiveve (mallrat ose materialet, makineritë e pajisjet), si rrjedhojë e mos

marrjes së masave efikase për ruajtjen e tyre.

17. Veprimeve të tjera të kësaj natyre që nuk përmenden më sipër me kusht që si pasojë e sjelljeve profesionale të paligjshme të zyrtarëve publikë i është shkaktuar dëm subjektit publik.

Masa e përgjegjësisë financiare sipas këtij neni, aplikohet e diferencuar, bazuar në pasojat e shkaktuara subjektit publik dhe përgjegjësisë së zyrtarit publik në linjën e autoritetit të subjektit.

#### **Neni 10**

##### **Përgjegjësia financiare e rënduar**

Përgjegjësia financiare e rënduar i referohet, shpërblimit të dëmit në një masë nga pesë deri në dhjetë herë mbi vleftën e plotë të tij, për shkak të karakterit sensitiv të aktiveve si; armët, municionet dhe materialet e tjera luftarake në përdorim të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, sigurinë, rendin publik dhe drejtësinë. Përgjegjësia e rënduar aplikohet vetëm për mungesat në inventar apo humbjes së aktiveve, ndërsa për dëmtimet e aktiveve, zbatohen njëlloj procedurat dhe rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

Rregullat e veçanta për aplikimin e përgjegjësisë së rënduar, si dhe lista e aktiveve dhe masa e përgjegjësisë financiare të rënduar, caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, sigurinë, rendin publik dhe drejtësinë.

#### **Neni 11**

##### **Përfshirja nga përgjegjësia**

Nuk ka përgjegjësi financiare dhe nuk mund të caktohet asnjë zhdëmtim, kur punonjësi provon se dëmi i shkaktuar, nuk është për faj të tij, ose ai ka qenë në kushtet e kërcënimit të jetës apo kur dëmi është shkaktuar nga forca madhore, fuqia e të cilave kanë qenë jashtë mundësisë së ndalimit apo kufizimit të pasojave nga punonjësi publik.

#### **Neni 12**

##### **Përgjegjësia financiare e punonjësit për dëmet e shkaktuara të tretëve**

Në rastet kur subjekti publik është deklaruar fajtor nga një organ kompetent për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i tij, ndaj një subjekti tjetër publik apo privat, gjatë ushtrimit të detyrës

apo funksioneve të ligjshme, punonjësi që ka shkaktuar dëmin i detyrohen subjektit publik ku është i punësuar të shlyejnë dëmin e pësuar. Në rastet kur dëmi është shkaktuar nga punonjësit e subjektit të deleguar, ky i fundit përgjigjet për shpërblimin e dëmit, ndaj subjektit që ka kompetencën fillestare.

Procedurat e vlerësimit dhe të caktimit të përgjegjësisë financiare, si për subjektin publik ashtu edhe për subjektin e deleguar ndaj punonjësve të tij, i nënshtrohen procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

### **Neni 13**

#### **Përgjegjësia financiare e ish punonjësve të subjektit publik.**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për punonjësit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, që i kanë shkaktuar dëme subjektit publik por në kohën e zbulimit të dëmit, i kishin ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin. Për caktimin e përgjegjësisë financiare në këtë rast, zbatohen të njëjtat rregulla si për punonjësit që janë efektivë.

### **Kreu III**

#### **PROÇEDURAT E VLERËSIMIT TË DËMIT.**

### **Neni 14**

#### **Vlerësimi i dëmit në lekë**

Dëmi i shkaktuar, vlerësohet me vlerën aktuale të mbetur. Kjo vlerë përfaqëson vlerën aktuale të dëmit, me çmimet e tregut që veprojnë në zonën e subjektit, në ditën e shkaktimit të dëmit, ose kur kjo nuk është e mundur në ditën e zbulimit të tij. Nga kjo vlerë zbritet amortizimi, që del duke shumëzuar vlerën e tregut të aktivitetit me shkallën (përqindjen) e amortizimit të tij në kontabilitet.

Në të gjitha rastet shuma e dëmit nuk mund të jetë më e vogël se vlera e pasurisë, sipas të dhënave të kontabilitetit.

Kur dëmi i është shkaktuar një objekti për të cilën subjekti publik, nuk ka akoma një vlerë të përcaktuar në momentin e shkaktimit të dëmit, vlera e dëmit caktohet nga ekspertët.

#### **Neni 15**

##### **Vlerësimi i dëmit në monedhë të huaj**

Nëse dëmi i shkaktuar, është i vlerësuar në monedhë të huaj, konvertimi i tij me monedhën vendase bëhet me kursin zyrtar të shitjes, të publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën që ka ndodhur dëmi dhe kur kjo nuk është e mundur, në ditën që është zbuluar.

#### **Neni 16**

##### **Fitimi i munguar**

Fitimi i munguar, për efekt të vlerësimit të dëmit llogaritet, duke shumëzuar vlerën e dëmit të llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 14-15, me normën mesatare të interesit të bonove të thesarit me afat maturimi një vjeçar, të korrigjuar me periudhën nga data e shkaktimit/zbulimit deri në caktimin e zhdëmtimit.

Fitimi i munguar aplikohet vetëm në rastin kur punonjësi ka përgjegjësi financiare të plotë.

#### **Neni 17**

##### **Caktimi i ekspertëve**

Kur nga autoriteti që përcakton përgjegjësinë financiare ose nga pala që ka shkaktuar dëmin, vlerësohet se aktivet e dëmtuara nuk kanë çmime apo një vlerë të regjistruar në kontabilitetin e subjektit publik, ose për vlerësimin e përgjegjësisë financiare, nevojiten njohuri të veçanta, autoriteti që vlerëson përgjegjësinë financiare, mund të caktojë ekspertë. Shpenzimet e ekspertimit përballohen nga pala që ka kërkuar ekspertimin.

#### **Kreu IV**

### **PROCEDURAT E REALIZIMIT TË PËRGJEGJËSISË FINANCIARE**

#### **Neni 18**

##### **Burimet për të nisur procedurën e caktimit të përgjegjësisë financiare**

Burimet për të nisur procedurën e caktimit të përgjegjësisë financiare i referohen raporteve të strukturave të financës, auditimit të brendshëm, Kontrolli të Lartë të Shtetit, vendimeve të formës së prerë të gjykatave, apo çdo informacioni zyrtar që vërteton shkaktimin e një dëmi pasuror ndaj subjektit.

#### **Neni 19**

##### **Autoriteti për caktimin e përgjegjësisë financiare**

Kur dëmi është shkaktuar nga punonjësit e të gjitha niveleve (përfshijtur titullarin e subjektit publik) dhe komisionet që funksionojnë brenda subjektit publik, të cilat marrin vendime me shumicë votash; kompetent për caktimin e përgjegjësisë financiare është, titullari i subjektit publik ose i ngarkuari i tij.

#### **Neni 20**

##### **Caktimi i përgjegjësisë financiare për titullarët dhe organet kolegjiale.**

Kur dëmi është shkaktuar nga:

1. Titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, procedurat e caktimit të përgjegjësisë financiare kryhen nga Avokatura e Shtetit. Këto procedura përfshijnë, këshillimin për zhdëmtimin e shumave të dëmeve në mënyrë vullnetare dhe kur kjo nuk pranohet, ngritjen e padisë gjyqësore.
2. Për titullarët ose administratorët e shoqërive tregtare, ku shteti zotëron më shumë se 50 % të aksioneve, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të organeve të qeverisjes vendore, kompetent për caktimin e përgjegjësisë financiare është; Bordi, Këshilli Drejtues i Ndërmarrjes apo Këshilli i Njësisë Qeverisjes Vendore, i cili vendos me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm.
3. Kur subjekt i përgjegjësisë financiare janë; bordet, këshillat drejtuese, apo këshillat e njësisë së qeverisjes vendore, zbatohen kërkesat e pikës 1 të këtij neni, nga Avokatura e Shtetit.

Kur për shkaktimin e dëmit çmohet se janë përgjegjës subjektet e përcaktuar në pikën 1-3 të këtij neni, strukturat që kanë zbuluar dëmin, ja referojnë kërkesën për caktimin e përgjegjësisë financiare, autoritetit kompetent që ka kompetencën për vendimmarrje të përcaktuara në nenin 19 dhe 20 të këtij ligji.

#### **Neni 21**

### **Seanca dëgjimore**

Pas marrjes së informacioneve sipas nenit 18, autoriteti i caktuar sipas nenit 19 dhe 20, cakton një seancë dëgjimore me punonjës/punonjës të pretendohet se kanë shkaktuar dëmin. Data e seancës dëgjimore i njoftohet punonjës të bashku me kopjet e dokumentacionit që vërtetojnë dëmin. Seanca dëgjimore caktohet jo më herët se 10 ditë nga nisja e njoftimit për seancë dëgjimore. Njoftimi dërgohet me postë zyrtare dhe kur është e mundur paralelisht edhe me postë elektronike.

Zhvillimi i seancës dëgjimore dokumentohet me proces verbal ose regjistrohet në audio kur kjo kërkohet nga palët dhe protokollohet në administratën e subjektit publik.

### **Neni 22**

#### **Njoftimi i palëve të interesuara**

Organi që shqyrton përgjegjësinë financiare të punonjësve, ka detyrimin që krahas punonjës, të njoftojë edhe palët e interesuara sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara në nenin 21. Si palë të interesuara paraqiten strukturat që kanë zbuluar dëmin dhe kanë rekomanduar fillimin e procedurave për caktimin e përgjegjësisë financiare. Në të gjitha rastet kur vlera e dëmit është më e madhe se 500.000 lekë njoftohet edhe Avokatura e Shtetit e cila konsiderohet palë e interesuar.

Mosparaqitja e palëve të interesuara pa arsye të përligjura, nuk e pengon procedurën e shqyrtimit dhe caktimit të përgjegjësinë financiare.

### **Neni 23**

#### **Mos paraqitja në seancë dëgjimore**

Pas marrjes së njoftimit, në se ka shkaqe të arsyeshme, me kërkesën e punonjës dhe me miratimin e autoritetit që do të caktojë përgjegjësinë financiare, seanca dëgjimore mund të shtyhet por jo më shumë se 5 ditë. Kur ekzistojnë kushte dhe pengesa ligjore për t'u paraqitur në seancë, seanca shtyhet aq kohë sa ekzistojnë pengesat plus pesë ditë. Kjo periudhë konsiderohet dhe llogaritet si ndërprerje e parashkrimit.

### **Neni 24**

**Të drejtat e punonjës në procedurën e caktimit të përgjegjësisë financiare.**

Punonjësi ndaj të cilit ka filluar një procedurë për caktimin e përgjegjësisë financiare, ka të drejtë; për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit për caktimin e përgjegjësisë financiare, për t'u informuar lidhur me dëmin faktik të pretenduar dhe provat në ngarkim të tij, për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova shtesë, për të kërkuar ekspertë, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar nga një avokat, këshillues ligjor ose një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar të titullarit të subjektit publik.

## **Neni 25**

### **Kriteret për vlerësimin e përgjegjësisë financiare**

Në caktimin e masës së përgjegjësisë financiare, organi i ngarkuar me caktimin e përgjegjësisë financiare, vlerëson:

1. Rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi, faktorët objektivë dhe subjektivë.
2. Motivin dhe shkallën e përfshirjes së punonjësit në shkaktimin e dëmit.
3. Përpijekjet e punonjësit për të shmangur dëmin.
4. Mundësitë financiare të punonjësit për shpërblimin e dëmit.
5. Kushte të tjera vetjake të punonjësit.

## **Neni 26**

### **Njoftimi i vendimit**

Autoriteti që merr vendimin për caktimin e përgjegjësisë financiare, njofton zyrtarisht me shkrim punonjësin, si dhe palët e interesuara, jo më vonë se dhjetë ditë pune, nga zhvillimi i seancës së fundit dëgjimore. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar, për shkaqet e caktimit të përgjegjësisë financiare dhe duhet të përmbajë detyrimisht, shumën e dëmit të ngarkuar për zhdëmtim dhe mënyrën e shlyerjes së tij si dhe të drejtën dhe afatin e ankimit.

## **Neni 27**

### **Ankimi**

Kundër vendimit për caktimin e përgjegjësisë financiare, punonjësi mund të paraqesë ankim në gjykatën administrative brenda 30 ditëve nga koha që ka marrë dijeni. Të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të organeve që caktojnë përgjegjësinë financiare e kanë edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Avokatura e Shtetit.

Ankimi në gjykatë, e pezullon ekzekutimin e vendimit të organit që ka caktuar

përgjegjësinë financiare.

### **Neni 28**

#### **Titulli ekzekutiv**

Kur punonjësi nuk është ankuar në gjykatën kompetente dhe me kalimin e afateve të ankimit sipas nenit 26 të këtij ligji, njoftimi i caktimit të përgjegjësisë financiare, shndërrohet në titull ekzekutiv. Konsiderohet titull ekzekutiv edhe njoftimi i subjektit publik ndaj subjekteve ku janë të punësuar ish punonjësit të cilët kanë shkaktuar dëme ose janë debitorë për ekzekutimin e detyrimit. Kundër njoftimit, debitori mund të paraqesë ankim në gjykatën administrative brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ankimi në gjykatë e pezullon ekzekutimin e detyrimit.

### **Neni 29**

#### **Shlyerja e detyrimit**

Shlyerja e detyrimit mund të bëhet vullnetarisht nga punonjësi publik që është ngarkuar për zhdëmtim, nëpërmjet derdhjes në llogari të subjektit të të gjithë shumës së detyrimit, ose pjesë-pjesë, sipas përcaktimit të autoritetit që ka caktuar përgjegjësinë financiare, si dhe nëpërmjet ndalesave nga paga.

Masa e ndalesës nga paga për shlyerjen e detyrimit, nuk mund të jetë më e madhe se 25 përqind e pagës neto mujore të punonjësit kur ka një detyrim dhe 35 përqind kur ka më shumë se një detyrim.

### **Neni 30**

#### **Mbarimi i detyrimit**

Detyrimi i punonjësit për dëmin e shkaktuar ndaj subjektit publik mbaron kur; ai shlyhet tërësisht, kur punonjësi vdes ose kur del në pension. Përrjashtim nga ky rast bëjnë detyrimet që lindin sipas pikës 1,2 dhe 7 të nenit 6 dhe nenit 10 të këtij ligji për të cilat zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

### **Neni 31**

#### **Parashkrimi**

E drejta e subjektit publik për të kërkuar zhdëmtimin e dëmeve, rrjedhë e përgjegjësisë financiare të punonjësve/organeve kolegjiale sipas këtij ligji, parashkruhet me kalimin e gjashtë muajve nga dita që është zbuluar dëmi dhe me kalimin e tre vjetëve nga dita që është shkaktuar. Këto afate ndërpriten në rastin kur ndaj punonjësit ka filluar ndjekja penale ose për

shkaqe të parashikuara në këtë ligj. Ndërprerja zgjat për aq kohë sa organi i ndjekjes penale ose gjykata nuk ka dhënë një vendim përfundimtar.

## **Kreu VI**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 32**

##### **Dispozitë tranzitore.**

Të gjitha detyrimet debitore të pranuar nga punonjësit, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen titull ekzekutiv dhe në se nuk shlyhen vullnetarisht i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm.

#### **Neni 33**

##### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të përcaktojë listën e aktiveve, që në rast humbjeje i nënshtrohen aplikimit të përgjegjësisë së rënduar si dhe masat dhe procedurat e aplikimit të kësaj përgjegjësie referuar nenit 10 të këtij ligji.

#### **Neni 34**

##### **Referimi në dispozita të tjera**

Për aq sa nuk është parashikuar në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurave Administrative dhe të Kodit të Punës.

#### **Neni 35**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në fletoren zyrtare. Çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

**KRYETARI**

**Niko PELESHI**



Tiranë, me 16.12.2026

**RELACION SHPJEGUES**  
**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR PËRGJEGJËSINË FINANCIARE TË PUNONJËSVE**  
**PUBLIKË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.**

Projektligji “ Për përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë ”, propozohet nga deputeti Bujar Leskaj dhe synon:

- ☞ Të vendosë procedura dhe të rregullojë marrëdhëniet që lindin midis subjekteve publikë dhe punonjësve publikë, lidhur me dëmet e shkaktuara prej këtyre të fundit, në periudhën që ata janë/kanë qenë të punësuar ose në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik.
- ☞ Synimi i kryesor i projekt ligjit është mbrojtja e burimeve publike nga veprimtaria e kundraligjshme e punonjësve publikë që me dashje ose nga pakujdesia i shkaktojnë dëme interesave publike.
- ☞ Projekt ligji pritet të ketë efekte parandaluese në përdorimin abuziv të burimeve publike, korrupsionit dhe të shtojë efektivitetin dhe efikasitetin e përdorimit të këtyre burimeve.
- ☞ Të rrisë dhe forcojë përgjegjëshmërinë menaxheriale dhe profesionale të punonjësve publikë dhe të kufizojë arbitraritetin e tyre në vendimmarrje.
- ☞ Mbrojtjen e burimeve publike nëpërmjet vënies në arkëtim në mënyrë të shpejtë të detyrimeve, rrjedhojë e dëmeve që i janë shkaktuar atyre.
- ☞ Miratimi i projekt ligjit do të pakësojë ndjeshëm volumin e çështjeve gjyqësore në gjykatat civile dhe administrative, duke i zgjidhur konfliktet në rrugë administrative.
- ☞ Uljen në tërësi të kostove administrative në procesin e rikuperimit të dëmeve.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projekt ligji i propozuar nuk është pjesë e programit analitik të projekt-akteve për vitin 2022 nga Qeveria por vjen si një rekomandim i përsëritur i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nevoja e këtij projekt ligji buron nga kontradikta e dukshme që ekziston midis dëmeve të shaktuara ndaj burimeve publike nga punonjësit publikë gjatë ushtrimit të detyrës, përkundër rikuperimit tyre në arkën e shtetit. Projekt ligji është një instrument komplementar dhe në sinkron me politikën e qeverisë dhe strategjinë e saj antikorrupsion.

Angazhimi im lidhur me përgaditjen e këtij projekt ligji, vjen si nevojë për t'i dhënë zgjidhje ngërçit të krijuar në rikuperimin e dëmeve të shkaktuara burimeve publike nga punonjësit publikë gjatë ushtrimit të funksioneve tyre, me dashje, nga pakujdesia apo mungesa e përgjegjëshmërisë profesionale. Projekti është produkt i konsultimeve të gjëra me ekspertë të financave publike, juristë dhe specialistë të shumë fushave dhe pritet të jetë një instrument efikas për të mbrojtur pronën publike dhe për të disiplinuar zyrtarët dhe vendimarrësit që menaxhojnë këto burime, në mënyrë operative.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, njësitë e auditimit të brendshëm apo të inspektimit financiar, kanë zbuluar dhe raportuar herë pas here shuma të konsiderueshme dëmsh, të shkaktuara nga veprimtaria e nëpunësve publikë, por mundësia e arkëtimit tyre është mjaft e komplikuar, pasi kompetente për të caktuar zhdëmtimin është vetëm gjykata. Kjo është sanksionuar në nenin 27/4 të Kodit të Punës sipas të cilit vetëm gjykata mund të japë një verdikt mbi përgjegjësinë materiale të punonjësve dhe nenit 117 sipas të cilit zbritjet nga paga e punonjësit bëhen vetëm për të ndalur tatimin ose me autorizimin me shkrim të punonjësit. Nga ana tjetër Gjykata e Lartë me vendimin e saj Nr.1354, datë 6.10.2005, në kundërshtim me praktikën më të mira vendeve të botës, ka konfirmuar se instituti i përgjegjësisë materiale në Shqipëri nuk ekziston dhe e ka unifikuar këtë me përgjegjësinë civile.

Situata aktuale kur për të vënë në arkëtim shuma të caktuara dëmsh duhet t'i drejtohesh gjykatës edhe për faktin se punonjësit në shumicën e rasteve nuk janë dakord të dëmshpërblejnë vullnetarisht, ka krijuar një ngërç të madh në rikuperimin e dëmeve. Kjo sepse sic është e njohur për të gjithë, vënia në arkëtim nëpërmjet procedurave gjyqësore bart një kosto të lartë administrative dhe kërkon një kohë shumë të gjatë. Nëse i referohemi raporteve të publikuara nga KLSH dhe Auditimi i brendshëm, rezulton se vetëm për vitin 2019 shkeljet e disiplinës financiare me dëm efektiv llogariten në 28 miliard e 312 milion lekë. Prapa këtyre shifrave

qëndrojnë dhjetra mijëra zyrtarë publikë, që vlerësohet se janë përgjegjës për këto shkelje. E në se për rikuperimin e këtyre dëmeve do t'i drejtoheshim gjykatës, atëherë kjo do të mjaftonte për t'a futur në kolaps sistemin gjyqësor, i cili nuk ka kapacitete të mjaftueshme për shqyrtimin e rasteve, pa përmendur kostot administrative shumë të larta që kërkon ky proces.

Projekti synon që pa cënuar në asnjë rast dispozitat e mësipërme por as të drejtën e punonjësve për një ankim përfundimtar në gjykatë, të sjellë një zgjidhje administrative të ndërmjetme të këtyre konflikteve në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe në funksion të interesit publik. Projekti synon gjithashtu që të zhvillojë procedurë lidhur me caktimin e zhdëmtimit dhe ti hapë rrugë dialogut lidhur me këtë proces, nëpërmjet transparencës, të drejtës për t'u mbrojtur për të paraqitur prova dhe për t'u ankuar, kundrejt një vendimi përfundimtar të administratës. Sipas projektit vendimet e administratës për caktimin e zhdëmtimit pezullohen, në se ato ankimohen nga punonjësit publikë në gjykatën kompetente.

Nga praktika e shqyrtimeve gjyqësore rezulton se shpesh herë kanë dështuar përpjekjet e administratës për të caktuar zhdëmtim ndaj punonjësve të tyre për shkak se nuk janë shqyrtuar rrethanat që është shkaktuar dëmi, por caktimi i zhdëmtimit është mjaftuar me raportet e auditimit. Ky dështim vjen edhe sepse nuk ka procedurë të tilla të unifikuara në sektorin publik lidhur me shqyrtimin e dëmeve, gjë e cila gjen zgjidhjen e duhur në këtë projekt.

Projekt ligji kërkon të rrisë në një shkallë shumë të lartë përgjegjëshmërinë menaxheriale dhe profesionale të punonjësve publikë. Në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, përgjegjëshmëria menaxheriale konsiderohet në tërësi si një parakusht për menaxhimin efikas të burimeve publike por ky ligj nuk ka instrumentet e duhura për ta realizuar atë. Projekti vjen pikërisht si një instrument komplementar për të sanksionuar dhe rritur përgjegjëshmërinë menaxheriale dhe profesionale në të gjitha nivelet, duke përcaktuar llojet e përgjesisë financiare, rastet sipas llojeve dhe përgjegjësitë respektive.

Projekti sjell disa risi dhe zhvillime në fushën e përgjegjësisë financiare duke klasifikuar llojet e kësaj përgjegjësie. Kështu përveç përgjegjësisë së plotë, e cila përfshin dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar, projekti zhvillon koncepte të reja të përgjegjësisë financiare si; përgjegjësinë e kufizuar, përgjegjësinë e përbashkët, përgjegjësinë specifike të zyrtarëve publikë dhe përgjegjësinë e rënduar. Gjithashtu si një risi, vjen edhe përgjegjësia e organeve kolegjiale për vendimmarrjet e tyre, qoftë ato të bordeve apo këshillave drejtuese të ndërmarrjeve publike ashtu edhe të këshillave të organeve të qeverisjes vendore. Projekti ka zhvilluar koncepte të reja në fushën e përgjegjësisë financiare, si ajo që lidhet me sjelljen profesionale të paligjshme, e cila u adresohet tërësisht zyrtarëve publikë dhe ka përcaktuar sanksionet përkatëse që mund të aplikohen në rastet kur vërtetohen këto sjellje.

Duke vazhduar argumentet lidhur me përparësitë dhe risitë e projektit lidhur me përgjegjësinë financiare, "përgjegjësia e plotë" e punonjësit publik, konsiston në detyrimin e tij për të kompensuar subjektin publik, në vlerën e plotë të dëmit pasuror të shkaktuar, plus fitimin e munguar. Rastet e përgjegjësive së plotë të punonjësit publikë përfshijnë dëmin e shkaktuar me dashje, ose dëmet e shkaktuara nga vendimmarrje ose sjellje profesionale në keq besim, dëmin e shkaktuar rrjedhojë e përgjegjësive penale, dëmin e shkaktuar nga punonjësi në gjendje të dehur ose nën efektin e lëndëve psikotrope, parashkrimi i një të drejte pasurore të subjektit publik për faj të punonjësit, efektet dhe dëmet e shkaktuara nga mos zbatimi i vendimeve gjyqësore, që përfshijnë pagesat pas hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor të formës prerë, mungesat në inventar të aktiveve ose mungesat e çfarëdo vlere që i është besuar në administrim punonjësit publik etj. të kësaj natyre.

Përgjegjësia e kufizuar presupozon zhdëmtimin nën kufijtë e vlerës së plotë të dëmit të shkaktuar dhe parashikohet të aplikohet në rastet kur; punonjësi ka bërë përpjekje për zvogëlimin e dëmit të shkaktuar dhe provon se ka qenë në pamundësi për të ndaluar gjithë pasojat, dëmi i shkaktuar nuk lidhet vetëm me fajin e punonjësit por edhe me përgjegjësinë e vetë subjektit publik, punonjësi nuk i kishte njohuritë e duhura tekniko profesionale etj. Përgjegjësia e kufizuar, ndryshe nga përgjegjësia e plotë dhe përgjegjësia civile, duhet të marrë në konsideratë edhe kushtet vetjake të punëtorit ose nëpunësit si dhe mundësinë financiare të shlyerjes së dëmit prej tij. Pavarësisht nga shuma e dëmit përgjegjësia materiale e kufizuar nuk mund të kalojë  $\frac{1}{4}$  e pagës mujore të punonjësit dhe nuk mund të shtrihet për një periudhë shlyerje më tepër se dhjetë vjet.

Një komponent tjetër i përgjegjësive financiare i parashikuar në këtë projekt, është përgjegjësia financiare specifike e zyrtarëve publikë. Sipas projektit, përveç përgjegjësive së plotë dhe të kufizuar të parashikuar në nenin 6-8 të projektit, zyrtarët publikë në të gjitha nivelet, janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara subjektit publik, rrjedhojë e sjelljeve të paligjshme profesionale apo e vendimmarrjeve të tyre të gabuara, të cilat nuk janë kryer me dashje direkte. Përgjegjësia e zyrtarëve publikë sipas këtij neni është deri shtatë paga mujore bruto por nuk mund të jetë më e madhe se 25 përqind e shumës së dëmit të llogaritur. Zyrtarët publikë janë gjithashtu përgjegjës edhe për dëmet e shkaktuara nga punonjësit në vartësi të tyre deri në masën e një page mujore. Spektri i kësaj përgjegjësie përfshin një gamë të gjërë parregullsish dhe shkeljesh si; vendimmarrjet e gabuara të anuluar nga gjykata kompetente, me vendim të formës së prerë ose nga organi administrativ më i lartë, të cilat kanë sjellë një dëm pasuror subjektit; përdorimit jo eficient të mjeteve financiare e konfirmuar kjo nga strukturat e auditimit; blerjes dhe krijimit të mallrave stoqe mbi nevojat e një viti pune; mos aplikimi i duhur i çmimeve dhe tarifave të ndryshme që ndikojnë negativisht në të ardhurat e subjektit; aplikimi i gabuar i grupeve, kategorive, shtesave ose elementëve që formojnë pagat e punonjësve; dhënia e shpërblimeve të padrejta punonjësve; marrjes në punë të personave mbi numrin e caktuar ose në kundërshtim me procedurat e rekrutimit të parashikuara në legjislacion ose në statutin e

subjekteve publike; pagimi i shpenzimeve për pritje e përcjellje, dhurata, në kundërshtim me ligjin dhe mbi normat e përcaktuar nga ligji; dëmit të shkaktuar subjektit si rrjedhojë e aplikimit të gjobave ndaj subjektit publik të vëna nga autoritetet publike për mos zbatimin e rregullave apo ligjeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë; blerjes së makinerive dhe e pajisjeve të cilat nuk vihen në shfrytëzim brenda gjashtë muajve nga data e blerjes. Parashikimet e këtij neni synojnë të disiplinojnë efektivitetin e shpenzimeve dhe të rritin përgjegjëshmërinë menaxheriale dhe profesionale të punonjësve publikë

Një lloji tjetër lloji i përgjesisë financiare i përcaktuar në këtë projekt është përgjegjësia e përbashkët e cila presupozon se; kur dëmi pasuror është shkaktuar nga disa punonjës, secili punonjës është përgjegjës për pjesën e dëmit të shkaktuar nga ai vetë. Por si një risi në këtë projekt që përfshihet në kategorinë e përgjegjesisë së përbashkët, vjen edhe përgjegjësia e organeve kolegjiale. Projekti ka përcaktuar se anëtarët e organeve kolegjiale, kanë përgjegjësi sipas qëndrimit të tyre në votim. Ata që votojnë kundër, në një proces vendimmarrje i cili ka sjellë një dëm pasuror, përjashtohen nga përgjegjësia. Projekti parashikon se anëtarët e organeve kolegjiale që janë të pranishëm në mbledhje dhe nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar nuk mund të abstenojnë. Abstenimi konsiderohet si votë pro. Projekti ka theksuar se përgjegjësia e përbashkët mund të jetë e plotë ose e kufizuar.

Projekt ligji, sjell edhe një lloj përgjegjësie të re dhe të panjohur deri tani, atë që quhet përgjegjësia e rënduar. Kjo lloj përgjegjësie i referohet shpërblimit të dëmit në një masë nga pesë deri në dhjetë herë mbi vleftën e plotë të tij, për shkak të karakterit sensitiv të aktiveve si; armët, municionet dhe materialet e tjera luftarake në përdorim të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, sigurinë, rendin publik dhe drejtësinë. Kjo çmohet e domosdoshme jo vetëm për të mbrojtur aktivet me karkater sensitiv por edhe për faktin se abuzimi me to mund të ketë pasojë në rritjen e kriminalitetit në jetën shoqërore. Në projektligj është bërë kujdes që kjo përgjegjësi të aplikohet vetëm për ato faktorë që potencialisht mund të ndikojnë në shtimin e kriminalitetit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjet: nr. 8085, datë 13.3.1996; nr.9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015); ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjin Nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", ligjin nr 9936 datë 26.06.2008 "Per menaximin e sistemit buxhetor ne RSH i ndryshuar" dhe ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi vendas dhe ndërkombëtar.

## **V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projekt ligji "Për përgjegjësinë financiare të nëpunësve publikë" synon të arrijë një përafrim më të mirë të kuptimit të përgjegjësisë financiare të punonjësve publikë me praktikën më të mirë të vendeve të BE. Ai në vetvete nuk përfaqëson ndonjë përafrim konkret me ndonjë akt të ngjashëm të këtyre vendeve, për shkak të specifikave të vendit tonë që konsistojnë:

- ✓ Mungesën e parashikimit të përgjegjësisë financiare në Kodin e Punës apo ligje të tjera vecanta,
- ✓ Mungesën e procedurave ligjore për caktimin e përgjegjësisë financiare
- ✓ Pozicionin e pafavorshëm të shtetit në këtë proces

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Projekt ligji i paraqitur përmban pesë kapituj si; Pjesa e përgjithëshme, Llojet e përgjegjësisë Financiare, Procedurat e vlerësimit të dëmit, Procedurat e caktimit të përgjegjësisë financiare si dhe Dispozitat e fundit.

Në pjesën e përgjithëshme projekti ka përcaktuar objektin, qëllimin dhe fushëveprimin e ligjit si dhe ka dhënë që në hyrje të tij, qëndrimin e ligjvënësist ndaj përgjegjësisë së punonjësve publikë për shpërblimin e dëmit duke sanksionuar detyrimin për këtë shpërblim. Projekti, përveç objektit dhe qëllimit të ligjit, ka parashikuar edhe fushëveprimin e tij i cili përfshin: "Përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë, si dhe çdo personi apo subjekti që kryen funksione shtetërore ose funksione të deleguara, gjatë kohës së punësimit ose të marrëdhënies punës me subjektin publik në; Njësitë e qeverisjes së përgjithëshme, në ndërmarrjet shtetërore dhe në shoqëritë tregtare ku shteti zotëron mbi 50 përqind të aksioneve". Fushëveprimi i këtij ligji synon të vejë nën kontroll dhe të disiplinojë çdo para publike që shpenzohet nga buxheti i shtetit apo çdo asset publik. Shtrirjes së fushëveprimit, i vijnë në ndihmë neni përkatës "Përkufizime", i cili përcakton qartë kuptimin e shtrirjes së ligjit si për sa i përket subjekteve publike ashtu edhe punonjësve publikë. Përkufizimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit synojnë ta bëjnë funksional ligjin dhe të japë pikëpamje shtruesë duke mos lënë shteg për interpretime të ndryshme gjatë implemtimit të tij. Kështu në kuptim të këtij ligji janë përcaktuar qartë koncepte të tilla, si subjekt publik, punonjës publik, njësi e qeverisjes së përgjithëshme, organe kolegjiale, përgjegjësi financiar, dëm pasuror, sjellje profesionale e paligjshme etj., terma të cilat ndeshen dëndur në përmbajtjen e projekt ligjit.

Në kreun e dytë të projektit, përveç sa shpjeguar edhe në pikën III të këtij relacioni, janë dhënë llojet e përgjegjësive financiare si kategori, si; përgjegjësia e plotë, përgjegjësia e kufizuar, përgjegjësia e përbashkët, përgjegjësia e rënduar dhe përgjegjësia specifike e zyrtarëve për vendimarrjet e tyre. Për të gjitha këto tipe përgjegjësish, janë bërë përpjekje për të përcaktuar edhe rastet më tipike por gjithësesi për shkak të gamës së gjërë të dëmeve dhe tipologjisë së tyre, i është lënë hapësirë autoritetit publik për të përcaktuar lloje të tjera dëmsh, që nuk përfshihen në listën përkatëse, me kusht që dëmi i shkaktuar të jetë real për subjektin. Në këtë kapitull projekti ka zhvilluar edhe disa koncepte, si atë të përshtimit nga përgjegjësia, e cila lidhet me mungesën e fajit në shkaktimin e dëmit ose kur punonjësi publik ka qenë në kushtet e pamundësisë për të parandaluar dëmin, kur i është kërcënuar jeta, ose dëmi është shkaktuar nga forca madhore.

Projekti gjithashtu synon të rregullojë edhe përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë kur gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre i shkaktojnë dëme një subjekti tjetër publik apo privat. Në këtë rast projekti parashikon përgjegjësinë primare të subjektit publik ndaj një subjekti tjetër publik a privat për dëmet e shaktuara nga punonjësit e tij por edhe të drejtën e subjektit publik për të kërkuar zhdëmtimin nga punonjësit publikë të subjektit. Duke qenë se lëvizja e punonjësve publikë nga një subjekt publik në tjetrin apo edhe nga një subjekt publik në një subjekt privat, ka pamundësuar rikuperimin e dëmeve të shaktuara më parë nga punonjësi publik, projekti parashikon një zgjidhje të favorshme duke prioritetizuar të drejtën e subjektit publik por pa mohuar të drejtën e ankimit të punonjësve ndaj akteve administrative për caktimin ose njoftimin e zhdëmtimit.

Procedurat e vlerësimit të dëmeve të shaktuara, të paraqitura në këtë projekt në kreun e tretë, synojnë unifikimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve dhe parandalimin e abuzimeve në këtë drejtim. Kjo për shkak se në praktikën administrative dhe gjyqësore janë vërtet qëndrime të ndryshme për vlerësimin e dëmeve, të cilat bëhen shkak për abuzime dhe korrupsion në këtë proces. Kriteret e caktuara për vlerësimin e dëmit mbështeten në teoritë e së drejtës por edhe në standartet ndërkombëtare të kontabilitetit. Është bërë kujdes që këto kriterë, të përfshijnë të gjitha pasuritë publike pavarësisht nëse janë të regjistruar në kontabilitet, kanë marrë ose jo një vlerë përfundimtare etj. Për këtë qëllim projekti i ka krijuar mundësi palëve në proces të përdorin ekspertët e pavarur. Në këtë kapitull është përcaktuar edhe baza metodologjike e llogaritjes së fitimit të munguar për të unifikuar qëndrimet e ndryshme të aplikuara në këtë fushë.

Përcaktimi i procedurave për caktimin e përgjegjësive financiare dhe unifikimi i tyre ka qenë një ndër synimet kryesore të projektit edhe për shkak të mungesës që vërehet në mjedisin tonë. Projekti ka përcaktuar autoritetet për të nisur një procedurë të caktimit të përgjegjësive financiare dhe burimet për të iniciuar një procedurë të tillë. Duke qenë se subjektet e kësaj përgjegjësie janë të ndryshme në pikëpamje të kategorive edhe autoritetet për caktimin e përgjegjësive duhet të jenë të ndryshme dhe jashtë konfliktit të interesave. Por ndërsa autoriteti

për caktimin e përgjegjësisë financiare për punonjësit publikë , i është adresuar titullarit të njësisë publike, kujdes është bërë në projekt për të përcaktuar autoritetin për caktimin e përgjegjësisë financiare, në rastin kur dëmet janë shkaktuar nga vetë titullarët e subjektit publik ose organet kolegjiale, duke e adresuar këtë autoritet, respektivisht te organet kolegjiale për titullarët dhe te Avokati i Shtetit, kur dëmet janë shkaktuar nga vendimarrjet kolegjiale.

Në themel të këtyre procedurave është negociimi midis palëve për të arritur një përfundim të pranuar por kjo nuk përjashton të drejtën e autoritetit për të caktuar një zhdëmtim si dhe të punonjësit publik për t'u ankuar kundër një vendimi përfundimtar të autoritetit. Nga ana tjetër kjo procedurë bazohet në parimet e trajtimit të barbartë, transparencës, pa anshmërisë etj. Projekti ka sanksionuar të drejtën e punonjësve publikë; për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit për caktimin e përgjegjësisë financiare, për t'u informuar lidhur me dëmin faktik të pretenduar dhe provat në ngarkim të tij, për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova shtesë, për të kërkuar ekspertë, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar nga një avokat, këshillues ligjor ose një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar të titullarit të subjektit publik. Projekti ka parashikuar edhe disa kriteret bazë për caktimin e përgjegjësisë financiare që duhet të mbahen parasysh nga autoritetit gjatë procedurës së caktimit të zhdëmtimit si; rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi, faktorët objektivë dhe subjektivë, motivin dhe shkallën e përfshirjes së punonjësit në shkaktimin e dëmit, përpjekjet e punonjësit për të shmangur dëmin, mundësitë financiare të punonjësit për shpërblimin e dëmit, kushte të tjera vetjake të punonjësit, kriteret të cilat i japin këtij procesi një karakter thellësisht të drejtë dhe social.

Përveç të drejtës së ankimit të palës së dëmtuar ndaj vendimit të autoritetit për caktimin e zhdëmtimit, për të parandaluar abuzimet eventuale nga autoritetet , projekti i ka dhënë hapësirë edhe palëve të interesuara për të bërë ankim, si Kontrollit të Lartë të Shtetit apo Avokatit të Shtetit. Ky mekanizëm kontrolli, pritet të forcojë përgjegjëshmërinë e autoriteteve publike në caktimin e një zhdëmtimi të drejtë. Si një risi e rëndësishme paraqitet edhe fakti, për kualifikimin si titull ekzekutiv të detyrimeve të pranuar apo të njoftimit të detyrimit kur punonjësi publik i ka ndërprerë marrëdhëniet me subjektin publik. Kjo pritet të aktivizojë dhe të verë në arkëtim gjithë detyrimet e prapambetura të punonjësve publikë ndër vite, të cilat për shkaqe nga më të ndryshmet nuk janë vënë në arkëtim.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI**

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji janë parashikuar në nenin 3 të projektit dhe si të tilla janë; njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare ku shteti zotëron mbi 50 përqind të aksioneve. Praktikisht ky ligj zbatohet në të gjitha njësitë publike që shpenzojnë para publike ose kanë në pronësi aste publike.


## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është përgatitur në bashkëpunim me ekspertin z. Gjon Ndrejaj dhe është konsultuar edhe me ekspertë të tjerë të financave publike, të auditimit dhe juristë, të cilët kanë kontribuar me komente dhe sugjerime.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Miratimi i këtij projekt ligji, pritet të ketë një efekt pozitiv në të ardhurat e buxhetit nëpërmjet rikuperimit të dëmeve të shkaktuara ndaj tij, ndërkohë që implementimi nuk paraqet asnjë kosto shtesë në buxhet.

**Bujar LESKAJ**

  
**DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**